



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE**

**Podujevë, 30 korrik 2021**

Në bazë të nenit 11, 12.2 shkronja c), dhe 40.2 shkronjat a) g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2 paragrafët 1 dhe 3, nenet 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, nenet 14, 15 paragrafi 2.3; dhe 34 paragrafët 2.1; 2.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 korrik 2021, miratoi këtë;

**RREGULLORE**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA**  
**DHE GJOBA KOMUNALE nr.01-431/04-0014941/18**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoja komunale nr.prot.01-431/04-0014941/18 e datës 28 shkurt 2018.

**Neni 2**

Neni 6 fshihet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

Taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

1. Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Podujevës, lirohen nga taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Subjektet afariste që pretendojnë shlyerjen e borxhit si pasojë e mosushtrimit të aktivitetit afarist mund të parashtrorjnë kërkesë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik për shlyerjen e borxhit, duke ofruar dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës (Formularët e qarkullimit tre mujor zero-zero) për vitin apo vitet që pretendon sipas kërkesës ose dëshminë për pezullimin e aktivitetit të subjektit afarist për vitin përkatës, lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.
3. Subjektet afariste të cilat kanë pësuar dëme si pasojë e fatkeqësive elementare, për ndonjë shkak tjetër madhor ose arsye tjera objektive pa fajin e tyre, në bazë të dëshmimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe sipas kërkesës së parashtruar mund të ju shlyhet ngarkesa për vitin në të cilin kanë pësuar dëme.
4. Kërkesa për shlyerjen e borxhit.....10.00 €
5. Kërkesa për çertifikatë si dëshmi për kryerjen e obligimeve.....1.00 €

**Neni 3**

Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Nr.prot.01-431/04-0063165/21**  
**Podujevë**  
**30 korrik 2021**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**

